



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 4269 /2022  
Data: 14.06.2022

PROCESVERBALI  
I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e pestë -V- për vitin 2022 e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë 19.05.2022 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: **Sevdi Dernjani** (Nënkryetari i Komunës), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), **Nexhmedin Daci** (Drejtorja për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), Përfaqësues i OSB-së, **Bajrush Laçi** (Shef i Zyrës Ligjore), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Informim). Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të KPF-së, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Politikë dhe Financa.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Propozim vendim për transfer të mjeteve nga kategoria ekonomike rezerva në shpenzime kapitale.
3. Propozim vendim për miratimin e listës së tri komiteteve konsultative.
4. Informatë mbi mbrojtjen e mjedisit.
5. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim rendin e punës; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

## 2. Propozim vendim për transfer të mjeteve nga kategoria ekonomike rezerva në shpenzime kapitale.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Lindita Ballazhi** thekson:- janë tri projekte të cilat janë hequr nga lista e projekteve dhe mjetet e atyre projekteve kanë kaluar në kategorinë e rezervave dhe mjetet financiare të cilat kanë qenë të parapara për ato projekte kërkojmë që të transferohen në programin buxhetorë: Nga Nën-Programi Buxhetor – Parandalimi dhe Inspektimi i Zjarreve 18444 kodi funksional 0320 në kategorinë Shpenzimet Kapitale nga Rezerva komunale, fondi burimorë 10 GQ, shuma prej 5,000.00 €, transferohet: Në Nën-Programin Buxhetor – Parandalimi dhe Inspektimi i Zjarreve 18444 kodi funksional 0320 në kategorinë Shpenzimet Kapitale, në projektin kapital “Ndriçimi publik në zonat urbane dhe rurale” me kod 90573, shuma 5,000.00 €. Nga Nën-Programi Buxhetor – Shërbimet e Shëndetësisë Primare 75050 kodi funksional 0721 në kategorinë Shpenzimet Kapitale nga Rezerva komunale, fondi burimorë 10 GQ, shuma prej 5,000.00 €, transferohet: Në Nën-Programin Buxhetor – Shërbimet e Shëndetësisë Primare 75050 kodi funksional 0721 në kategorinë Shpenzimet Kapitale, në projektin kapital, “ Rregullimi i infrastrukturës në QKMF (Rregullimi i nxemjes)” me kod 51024 në shumë prej 5,000.00 €. Nga Nën-Programi Buxhetor – Planifikimi Urban dhe Inspeksioni 66480 kodi funksional 0620 në kategorinë Shpenzimet Kapitale nga Rezerva komunale, fondi burimorë 10 GQ, shuma prej 5,000.00 €, transferohet: Në Nën-Programin Buxhetor - Planifikimi Urban dhe Inspeksioni 66480 kodi funksional 0620 në kategorinë Shpenzimet Kapitale nga Rezerva komunale në projektin kapital, Ndërtimi (Rihapja, zgjerimi) dhe asfaltimi i rrugëve urbane dhe rurale në Han të Elezit” me kod 48910 në shumë prej 5,000.00 €.

**Refet Kalisi** thekson:- kërkoj sqarim për shpenzimet e shëndetësisë primare pse me u marr ato mjete. Ne kemi nevojë për te shëndetësia për shkak se nuk ka barna esenciale dhe është mirë që këto mjete mi shfrytëzuar për barna. Mjetet financiare duhet të dedikohen në të njëjtin program buxhetor sepse nuk mundemi që mjetet financiare me i bartë prej mallrave dhe shërbimeve në projekte kapitale por duhet në të njëjtën kategori mi transferuar. Është mirë që kompania e cila e ka fituar tenderin për rregullimin e nxemjes me filluar me kryer projektin për shkak se është objekt i ndishëm dhe sa më shpejt duhet të kryhet.

**Lindita Ballazhi** thekson:- projekti ka qenë tjetër dhe ai projekt është hequr nga lista e projekteve sepse këta projekte vite radhazi kanë qenë të njëjta dhe nuk janë realizuar dhe ato mjete i transferojmë në projektin për rregullimin e nxemjes në QKMF.

**Nexhmedin Daci** thekson:- kemi kontaktuar me kompaninë por ka potencuar se e kemi kontratë për dinamikën për me i realizuar punimet. Sa i përket projektit të ndriçimit publik ka kërkesa të reja nga qytetarët dhe për atë është planifikuar.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim ; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA PROPOZIM VENDIMI PËR TRANSFER TË MJETEVE NGA KATEGORIA EKONOMIKE REZERVA NË SHPENZIME KAPITALE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND



**Sherif Berisha** thekson:- është e vërtetë që kemi shtëpi ende që i kanë kulmet me mbuloje të azbestit por duhet të ndërmarrim diçka . Projekti që ka qenë mbi një milion euro vetëm e ka nxjerrë në sipërfaqe azbest çimenton dhe me norma ndërkombëtare ju e dini si është mbyllur azbestçimentoja sepse kanë vdekur dy ushtarë të KFOR-it që është konstatuar se aty e kanë marrë sëmundjen , ndërsa ne për çdo ditë po e thithim atë.

**Nexhmedin Daci** thekson:- projekti për rregullimin e shtratit të lumit Lepencë pikërisht për këtë arsye është miratuar prej Bankës Botërore dhe tash varet prej Qeverisë sepse nuk është projekt i vogël

**Kryesuesi** thekson:- ndotja prej kompanisë “Sharrcem” është më stresuese dhe është mirë me punuar në këtë drejtim. Duhet të punohet me të eliminuar ndotjet e tjera që janë përreth se do të ishte më mirë me zvogëluar ndotjen. Ndotje po shkakton edhe kompania e cila është duke i zhvilluar dhe është mirë që me të evituar dëmet që i shkakton për shkak se besoj që në kontratë e ka të paraparë . Duhet të pastrohet rruga në atë pjesë sepse është shumë e ndotur.

**Nexhmedin Daci** thekson:- jemi në kontakt të vazhdueshëm me atë kompani se i ka shkakuar edhe disa dëmtime të tjera e i kanë obligim me kontratë me të kryer ato punë. Sa i përket pastrimit kompania me ato mjete të cilat i ka nuk mundet me bërë pastrimin e rrugës. Ne e kemi angazhuar kompaninë që është e kontraktuar prej komunës për me pastrua atë pjesë dhe në momentin që do të përfundojnë punimet do të pastrohet përsëri.

**Sevdi Dernjani** thekson:- kompania është munduar me ju nejtë gati dëmeve të cilat i ka bërë sepse është tu kaluar një projekt i madh nëpër komunën e Hanit të Elezit por jemi edhe dëshmitarë se çka ka bërë kompania “Bektellenka” gjatë kryerjes së punimeve dhe balta ka qenë nëpër midis qytetit. Kjo kompani shumë mirë është duke i nejtë gati me kapacitet të cilat i ka.

**Refet Kalisi** thekson:- ndotje ka nuk mund ta mohojmë këtë çështje por edhe nëpër shtëpi në pavarësisht pse pastrojmë në mëngjes vërehet ndotja.

**Nexhmedin Daci** thekson:- po që se në këto momente e pastrojmë veturën dhe e parkojmë para shtëpisë dhe po ta shikoni pas tri ore keni me vërejtur se si bëhet vetura pra rrugës nëse kalon me veturë bëhet pluhur që donë të thotë se rrugët i kemi të pa pastërta. Po më vjen shumë keq që jeni duke paragjykuar se pluhur është tu ardhur vetëm prej kompanisë “Sharrcem”.

**Sherif Berisha** thekson:- tash e tutje do të potencojmë që pluhuri është duke ardhur prej komunës dhe unë e di që bëhet pluhur edhe prej veturave por kompania “Sharrcem” është njëri prej ndotësve më të mëdhenj. Pra sipas drejtorisë komuna është duke bërë pluhur dhe si ekzekutiv nuk e di se për çka keni ardhur në pushtet .

**Nexhmedin Daci** thekson:- dy muaj apo tre muaj ka qenë jashtë funksionit kompania “Sharrcem” dhe po që se shikohen rezultate të stacioni i monitorimit të ajrit ndotja është më keq.

**Sherif Berisha** thekson:- nuk mund të potenconi që nuk është punuar sepse tre muaj kanë punuar për me bërë remuntë furrën.

**Sevdi Dernjani** thekson:- në raport dhe në informatë të cilën e ka paraqitur i ka cekur indikatorët kryesorë të ndotjes në komunën e Hanit të Elezit.



**Ibadete Kalisi** thekson:- gjatë sezonës së verës kërkoj që mbledhja mbeturinave me u bërë gjatë natës për shkak të temperaturave të larta po kundërmon një aromë shumë e keqe.

**Arsim Dernjani** thekson:- nga data një qershor do të fillon bartja e mbeturinave në qytet , ndërsa për fshatra do ta diskutojmë.

**Kryesuesi** thekson:- ndotja nga “Sharrceci” është më e dëmshme te qytetarët dhe duhet të bëhemi bashkë mi i shikuar mundësit që me u zvogëluar ndotja. Ne e dimë që ka ndotje për banorët e Hanit të Elezit por këta banorë duhet t’i marrin edhe të mirat prej kësaj kompanie. Për këto politik është mirë me u bërë bashkë dhe me punuar në mënyrë që të jenë të kënaqur qytetarët. Ndotje ka edhe në komunën e Obiliqit por ata përfitojnë prej Qeverisë. Ne si qytetarë e pranojmë me një far mënyrë ndotjen ndërsa vijnë të huajt dhe i përfitojnë të mirat ndërsa ne asgjë.

**Nexhmedin Daci** thekson:- unë nuk jam te mbrojtur kompaninë “Sharrcem” sepse po që se do ta kisha mbrojtur në raport nuk e kisha paraqitur në rend të parë. Është mendimi imi atë që po e potencojë se nuk është kompania “Sharrcem” ndotësi më i madh , mirëpo parametrat e kësaj janë të dëmshëm.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### U VOTUA INFORMATA MBI MBRJTJEN E MJEDISIT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

### 5. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Sherif Berisha** thekson:- është mirë drejtorja e arsimit të del në fshatin Krivenik dhe ta viziton shkollën për shkak se rruga ishte shumë e dëmtuar. Shihen disa foto me KVRL-në dhe drejtorët e shkollave për disa projekte , kërkoj sqarim.

**Majlinda Kaloshi** thekson:- gjatë viti 2021 ish qeverisja e kaluar ka bërë marrëveshje në mes MAPL-së , CDF-së dhe Komuna për projektet ndikimi në komunitet . Komuna është e obliguar që 15 % të projektit me financuar ndërsa pjesën tjetër e kanë MAPL-ja dhe CDF-ja. Kanë aplikuar të rinjtë dhe i kemi ndihmuar në mënyrën e aplikimit dhe po besojmë që me kaluar ndonjë projekt i tyre. Ata kanë bashkëpunuar me shkollat për shkak se nuk kemi ndikim të drejtë për drejtë te ata por vetëm ua kemi ofruar ndihmën e nevojshme që ata e kanë kërkuar. Ata kanë bashkëpunuar në mes vete se projekti ka qenë për ndikim në komunitetet dhe te të rinjtë normalisht ka qenë nëpër shkolla.

**Refet Kalisi** thekson:- rruga është e rregulluar pavarësisht që shkolla është larg.

**Sevdi Dernjani** thekson:- si lëvizje vetëvendosje a e njehni komunën si institucion për shkak se është mënyra me e lehtë kur kritikojmë për shkak se mënyra e bashkëpunimit që keni pretenduar prej fillimit dhe unë kam potencuar se jam pro të cilën si lëvizje vetëvendosje e keni pasur derën të hapur dhe përsëri e keni. Dëshmitarë i kam drejtorë që kryetari i komunës ma ka tërhequr vërejtjen se pse nuk e kam publikuar një takim me z.Sherfi Bersha si asamblistë i vetëvendosjes dhe me drejtorin e Infrakosit dhe të arsyeshme e kam pa që mos me publikuar për shkak se kam pasur takime të vazhdueshme dhe i kam publikuar rregullisht. Për problemin e vendkalimeve jeni të njoftuar që po pretendohet me i mbyllur dhe institucionalishtë kemi dërguar shkresa kemi bërë takime për të cilat jeni të gjithë të njoftuar dhe së fundi vendosi me ardhur zëvendës



ministri dhe deputeti i komunës sonë . Në momentin që vijnë ne si institucion në komunë kemi vendosur me i prituri në mënyrë institucionale por ata nuk vijnë dhe zgjedhin vende të ndryshme si ViVa ,Alba, Zyra e vetëvendosjes, te Braft , mirëpo për kundër krejt kësaj kemi qenë të disponueshëm ku do me ardhën vetëm për me zgjedhur mënyrën e bashkëpunimit për me ju bërë zgjidhje qytetarëve dhe në momentin që bëhet publikimi ju vendosni që në vizitë në vend të ngjarje ka qenë vetëm zëvendës ministri dhe deputeti i Kuvendit të Kosovës por në vizitë isha unë së bashku me drejtorin e urbanizmit. Shumë mirë e dini që është një problem i trashëguar dhe na nëse duam me zgjidhur duhet të jemi të gjithë bashkë .

**Sherif Berisha** thekson:- ju si komunë asnjë herë nuk e keni ftuar z.Mirsad Shkretën në manifestime të ndryshme. Sa i përket vizitës unë kam qenë me ju ashtu siç kemi biseduar. Është mirë që i shikoni faqet e subjekteve politike por atje duhet ti jepni vërejtjet dhe te përshkrimi i zëvendës ministrit e ka potencuar që marrin pjesë edhe institucionet komunale . Problemet të cilat i keni pasur më herët me deputetin në fjalë rregulloni ju.

**Sevdi Dernjani** thekson:- nuk jemi të obliguar me ftuar dhe për këtë çështje mund t'i a dërgoni në kuvend pyetjen kryetarit të komunës. Unë e vlerësoj prezencën e juve shumë për çështjen e vizitës së zëvendësministrit. Në ftesës të cilën e ka bërë ambasada Zvicerane për projektet 2022-2025 unë kam marr pjesë dhe në tavolinë kam shkuar te z.Liburn Aliu ju kam prezantuar që jam nënkryetari i komunës së Hanit të Elezit dhe po dua me të informuar për problemet të cilat na u kanë shfaqur se a jeni në dioni dhe ka potencuar që jam në dioni por nuk kam çka të bëjë . Në të gjitha format jemi tu tentuar që me bërë zgjidhje por na vinë bashkëpunimi i juve që me mundur me bërë diçka me nivel qendrorë dhe nëse bëhet do vlerësojmë shumë.

**Kryesuesi** thekson:- jeni duke diskutuar për diçka që asnjëri nuk keni faj dhe z. Sherif Berisha ka qenë pro për me mbështetur komunën në ato variante siç ka dëshirë njeriu për vendin e vetë .

**Sevdi Dernjani** thekson:- ashtu siç është kryetari i komunës për interes të qytetarëve është edhe z.Mirsad Shkreta sepse të dytë kanë marr vota prej qytetarëve dhe gati se të njëjtin rol e kanë . Ne jemi duke bërë maksimumin për me zgjidhur këtë problem por ne ta bënë edhe ai prej anës së tjetër për me zgjidhur këtë problem pavarësisht se a flasin apo nuk flasin është krejt tjetër problem.

**Refet Kalisi** thekson:- edhe ne kemi pas biseduar për këtë çështje po ata kanë potencuar vetëm te pikat ekzistuese për shkak se pikën te bushtë dhe te stadiumi i futbollit nuk kanë leje sepse edhe ne kemi kërkuar por është problem. Pse nuk ka barna esenciale në QKMF. Personalisht unë kam mundësi me i blerë por ka qytetarë që nuk kanë mundësi me i blerë . Edhe pse çështjen e barnave esenciale e ka Ministria me i siguruar por është mirë me i shikuar mundësit buxhetore që edhe komuna me bërë furnizim .

**Sherif Berisha** thekson:- premtime kemi prej zëvendës ministrit që do të bëhet zgjidhje te vendkalimet. Është mirë me bërë zgjidhje për transmetimin direkt të seancave të kuvendit të komunës .


**Sevdi Dernjani** thekson:- në seancën tjetër besoj se do të bëhet transmetimi.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e shpallim të mbyllur mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:33.

**Procesmbajtësi**

**Avni Bushi**



**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Florim Shkreta**